



Duke u mbështetur në nenin 12.2 nën pikën d) dhe nenit 40.2 të nën pikën l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, nenit 10 nën pikën 4) të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë së Arsimit me 04nr.351-3875/16 të dt. 02.09.2016, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e XI-të të radhës për vitin 2016, të mbajtur më 29.12.2016 mori këtë:

V E N D I M

Për

Miratimin e Planit Komunal Zhvillimor të Arsimit 2017-2019

- I. Miratohet Plani Komunal Zhvillimor i Arsimit për periudhën 2017-2019.
- II. Plani si në pikën 1 të këtij Vendimi paraqet vizionin dhe prioritetet për zhvillimin e arsimit në Komunën e Klinës për periudhën 2017-2019.
- III. Plani me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna: nga debati me publikun, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi është modifikuar nga Grupi punues konform dispozitave ligjore në fuqi.
- IV. Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit 2017-2019 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
- V. Kompetentë për ekzekutimin e këtij Vendimi është Drejtoria e Arsimit me subjektet relevante për implementim.
- VI. Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL konform nenit 81 të LVL dhe nenit 18 të Rregullores së Qeverisë së RK për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave nr.01/2013.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit, Zyra për informim, një kopje për Shërbimin e Kuvendit dhe një Arkivin e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-128 2017
Klinë, më 12.01 2017

